

Selcom Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

Selcom Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,684,162	2,507,997
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	13,649,586	15,459,882
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	5,185,426	1,297,289
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	4,185,435	4,339,286
Inventari	8	3,600,087	135,461
Shpenzime të shtyra	9	498,768	1,370,292
Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara	10	4,027,463	3,290,992
Total Aktive Afatshkurtra		33,830,927	28,401,199
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	11	33,081,833	30,566,373
Aktive afatgjata jomateriale	12	50,272	35,140
Total aktive afatgjata		33,132,105	30,601,513
Total Aktive		66,963,032	59,002,712
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	6,671,669	6,627,111
Llogari të pagueshme tregtare	14	2,227,811	2,373,650
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	3,189,673	2,775,392
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16	2,635,139	2,140,271
Detyrime tatimore	17	1,717,297	1,889,621
Të ardhurat e shtyra	18	60,200	60,200
Të tjera detyrime	19	2,674,250	2,636,853
Total Detyrime afatshkurtra		19,176,039	18,503,098
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	20	7,456,190	10,598,285
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	21	22,612,667	23,349,675
Total Detyrime afatgjata		30,068,857	33,947,960
Totali i detyrimeve		49,244,896	52,451,058
Kapitali aksionar	22		
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		6,441,654	2,006,376
Fitime/ humbje të mbartura			(2,382,888)
Fitimi i ushtrimit		11,166,482	6,818,166
Total kapitali aksionar		17,718,136	6,551,654
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		66,963,032	59,002,712

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Selcom Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	61,454,546	54,136,598
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar		3,548,000	10,988,000
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	24	6,555	(14,317)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(40,595,132)	(49,330,585)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	25	(35,339,916)	(45,516,098)
2) Të tjera shpenzime	26	(5,255,216)	(3,814,487)
Shpenzime të personelit	27	(6,722,039)	(3,605,136)
1) Paga dhe shpërblime		(5,836,891)	(3,172,469)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetsore		(885,148)	(432,667)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11/12	(3,660,676)	(2,917,330)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28	103,166	(279,480)
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare	29	(851,356)	(700,334)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(1,060,297)	(644,027)
2) Shpenzime të tjera financiare		208,941	(56,307)
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		13,283,064	8,277,416
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	30	(2,116,582)	(1,459,250)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,116,582)	(1,459,250)
Fitimi/humbja e vitit		11,166,482	6,818,166
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		11,166,482	6,818,166

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Selcom Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Humbje të mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	100,000			(2,382,888)	2,016,376	(266,512)
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014						
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Fitimi / Humbja e vitit					6,818,166	6,818,166
Lëvizjet përmes kapitalit		10,000		2,006,376	(2,016,376)	-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	100,000	10,000	-	(376,512)	6,818,166	6,551,654
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015						
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit					11,166,482	11,166,482
Lëvizjet përmes kapitalit			6,441,654	376,512	(6,818,166)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	10,000	6,441,654	-	11,166,482	17,718,136

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

Altin Bushka
Administrator

SELCOM
SELECTED COMMUNICATION
Rezidenca "Kodra e Diellit", Tiranë
NUIK: K 61920009 K
Tel: (04) 4100000, (048) 830000

Mazars sh.p.k.
Hartues i Pasqyrave Financiare

MAZARS
Rr. Enver Hoxha, Pali "Bijlsket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	11,166,482	6,818,166
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	(191,465)	41,419
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	1,099,873	1,202,916
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,660,676	2,917,330
Rezultati nga shitja e aseteve	(56,718)	
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(1,788,937)	(12,219,425)
Rënie/(rritje) në inventarë	(3,464,624)	1,475,519
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(954,114)	(15,467,928)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	20,770	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	9,491,943	(15,232,003)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(6,264,932)	(17,717,725)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	130,380	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(6,134,552)	(17,717,725)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(3,163,750)	34,288,883
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(3,163,750)	34,288,883
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	193,641	1,339,155
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,507,997	1,232,370
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(17,476)	(63,528)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	2,684,162	2,507,997
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Selcom” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Korrik 2006 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lekë, i ndarë në 100 njësi të barabarta me nga 1,000 Lekë secila.

Ortakët e shoqërisë janë :

- Z. Gentian Sula zotërues i 65 kuotave ose 65% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Altin Bushka zotërues i 35 kuotave ose 35% të kapitalit të shoqërisë;

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ofrimi i shërbimeve të telefonisë, internetit. Projektim dhe zbatim i rrjeteve dhe sistemeve telefonike, rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, sistemeve të vëzhgimit me kamera IP dhe me qark të mbyllur. Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektronike.

Adresa e selisë së shoqërisë është: Selitë, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 14 punonjës (2014: 9 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paafësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahaseshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/ALL	137.28	140.14
USD/ ALL	125.79	115.23

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogaritë pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)***Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

a. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

b. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

c. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**d. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

e. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

f. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

g. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

h. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**i. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Mjete monetare në bankë	2,590,726	455,117
Llogari rrjedhëse	2,590,726	455,117
Mjete monetare në arkë	93,436	2,052,880
	2,684,162	2,507,997

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Klientë	13,649,586	15,459,882
	13,649,586	15,459,882

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të tjera të arkëtueshme nga BPO	106,333	-
Të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	5,079,093	1,297,289
	5,185,426	1,297,289

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Debitorë kreditorë të tjerë	4,185,435	4,339,286
	4,185,435	4,339,286

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Lëndë e parë dhe materiale	3,342,560	-
Mallra për rishitje	257,527	135,461
	<u>3,600,087</u>	<u>135,461</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	136,373	38,333
Parapagime për furnitorët	362,395	1,331,959
	<u>498,768</u>	<u>1,370,292</u>

10. Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara

Të arkëtueshmet nga të ardhurat e konstatuara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Të ardhura të llogaritura nga telefonia	4,027,463	3,290,992
	<u>4,027,463</u>	<u>3,290,992</u>

Selcom Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta dhe vegla pune	AQT në proces	Ndërtime dhe instalime	Të tjera	Totali
Kosto									
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	21,536,583	478,244	146,413	1,066,551	0	1,099,846	2,708,922	68,198	27,104,757
Shtesa	5,017,124	0	53,317	1,228,026	0	10,988,000	0	407,925	17,694,392
Riklasifikime	(5,090,593)			(81,641)	62,378		5,044,027	65,829	0
Pakësime									0
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	21,463,114	478,244	199,730	2,212,936	62,378	12,087,846	7,752,949	541,952	44,799,149
Shtesa	1,635,561	684,744	53,468	205,417			15,635,846	117,598	18,332,635
Pakësime	(21,626)			(70,000)		(12,087,846)			(12,179,472)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	23,077,049	1,162,988	253,198	2,348,354	62,378	0	23,388,795	659,550	50,952,312
Amortizimi i akumuluar									
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	9,035,354	55,795	111,583	385,430			1,664,362	63,506	11,316,029
Amortizimi i vitit	2,049,404	49,286	58,169	387,039	5,165		336,056	31,628	2,916,747
Riklasifikime	(122,357)			(127,846)	29,612		234,683	(14,092)	0
Pakësime									
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	10,962,401	105,081	169,752	644,623	34,777	0	2,235,101	81,042	14,232,776
Amortizimi i vitit	2,172,373	110,079	27,039	336,182	4,132		890,597	115,263	3,655,665
Riklasifikime									0
Pakësime	(12,130)			(5,833)					(17,963)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	13,122,644	215,160	196,791	974,972	38,909	0	3,125,698	196,305	17,870,478
Vlera neto kontabël									
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	12,501,229	422,449	34,830	681,121	0	1,099,846	1,044,560	4,692	15,788,728
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	10,500,714	373,163	29,978	1,568,313	27,601	12,087,846	5,517,848	460,910	30,566,373
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	9,954,406	947,828	56,407	1,373,382	23,469	0	20,263,097	463,245	33,081,833

12. Aktive Afatgjata Jo Materiale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	67,333	67,333
Shtesa	20,143	20,143
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	87,476	87,476
Amortizimi		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	32,193	32,193
Amortizimi i vitit	5,011	5,011
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	37,204	37,204
	-	-
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2014	35,140	35,140
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2015	50,272	50,272

13. Huat aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Overdraft ICB	6,671,669	6,627,111
	6,671,669	6,627,111

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitorë vendas	2,209,255	2,356,541
Furnitorë të huaj	18,556	17,109
	2,227,811	2,373,650

15. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të pagueshme të tjera ndaj palëve të lidhura	2,444,041	2,491,614
Të pagueshme tregtare nga palët e lidhura	745,632	283,778
	3,189,673	2,775,392

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime të konstatuara për telefoninë	2,635,139	2,140,271
	<u>2,635,139</u>	<u>2,140,271</u>

17. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	166,685	64,405
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	41,582	17,602
Tatim fitimi	1,099,873	1,309,316
TVSH për t'u paguar	409,157	498,298
	<u>1,717,297</u>	<u>1,889,621</u>

18. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Parapagim nga klient	60,200	60,200
	<u>60,200</u>	<u>60,200</u>

19. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Paga për t'u paguar	2,478,384	2,457,614
Debitorë & kreditorë të tjerë për modema	195,866	179,239
	<u>2,674,250</u>	<u>2,636,853</u>

20. Hua afatgjata

Huatë afatgjata detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Kredi ICB	7,456,190	10,598,285
	<u>7,456,190</u>	<u>10,598,285</u>

21. Të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të pagueshme të tjera ndaj ortakëve	22,612,667	23,349,675
	22,612,667	23,349,675

22. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 100, 000 Lekë. Gjate vitit 2015 nuk ka pasur ndryshim në strukturën e kapitalit të shoqërisë.

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga telefonia	50,843,926	45,492,647
Të ardhura nga interneti	10,350,062	7,375,516
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	260,558	1,268,435
	61,454,546	54,136,598

24. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitime nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	198,738	170,802
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(248,901)	(185,119)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	130,380	-
Vlera neto kontabël e aseteve të shitura	(73,662)	-
	6,555	(14,317)

Selcom Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	64,565,705
Garanci për modema	(169,167)
Anullim i të ardhurave të 2014 deklaruar në 2015	3,290,992
Përllogaritje e të ardhurave të 2015 deklaruar në 2016	(4,027,463)
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	63,660,067
Të ardhura telefoni/internet	61,193,988
Shitje mallra/materiale	260,558
Shitje AQT	130,380
Të ardhura nga prodhimi i AQT-së	3,548,000
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	65,132,926
Të ardhurat nga interesat	19,802
Të ardhura të tjera financiare	11,310
Fitim nga këmbimet valutore	407,679
Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Ftimit	65,571,717

25. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Kosto e materialeve	3,335,505	13,930,728
Materiale të tjera ndihmese	2,099,923	1,607,023
Kosto e mallrave të shitur	-	240,401
Nenkotraktore	29,517,488	29,737,946
Mirembajtje centrali	387,000	
	35,339,916	45,516,098

26. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime qeraje	1,703,851	615,098
Mirëmbajtje dhe riparime	773,062	116,290
Shpenzime transporti	244,745	65,435
Shpenzime administrative	66,472	581,087
Shërbime nga të tretë	14,045	35,814
Blerje të ndryshme, kancelari etj	91,308	37,823
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	96,896	257,119
Komisione bankare	704,095	474,423
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	9,000	4,083
Dhurata	67,585	63,008
Taksa dhe tarifa të ndryshme	777,488	410,693
Siguracione makina	15,500	-
Shpenzime noteriale për procedura kredie	-	75,295
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	603,961	1,078,319
Shpenzime për pritje	87,208	-
	5,255,216	3,814,487

27. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	5,836,891	3,172,469
Shpenzime për sigurime shoq. e shëndetësore	885,148	432,667
	6,722,039	3,605,136

28. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoba dhe penaltete	(103,166)	279,480
	(103,166)	279,480

29. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(1,091,409)	(667,640)
Të ardhura nga interesat	19,802	19,261
Shpenzime të tjera financiare	-	(35)
Te ardhura te tjera finaciare	11,310	4,387
Humbje nga këmbimet valutore	-	(78,415)
Të ardhura nga këmbimet valutore	208,941	22,108
	(851,356)	(700,334)

30. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	13,283,064	8,277,416
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	827,485	1,450,917
Shpenzime pritje & përcjellje	87,208	63,008
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	135,116	279,480
Shpenzime të tjera	605,161	1,108,429
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	14,110,549	9,728,333
Tatim fitimi @15%	2,116,582	1,459,250
	11,166,482	6,818,166

31. Transaksionet me palët e lidhura.

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
S&D Invest	616,685	258,390
Agi Kons	563,305	529,585
Albdesign	2,009,684	1,987,417
Gentian Sula	20,389,139	21,235,219
Altin Bushka	2,223,527	2,114,456
	<u>25,802,340</u>	<u>26,125,067</u>
 Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
BPO Solution	106,333	
S&D Invest Sha	142,812	27,825
Agi Kons	3,978,332	
Albdesign Shpk	957,949	1,269,464
	<u>5,185,426</u>	<u>1,297,289</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
S&D Invest Sha	114,987	115,351
Agi Kons	418,746	448,281
Albdesign Shpk	236,125	245,811
	<u>769,858</u>	<u>809,443</u>
 Blerje nga palët e lidhura		
S&D Invest Sha	616,684	697,304
Agi Kons	587,672	
Albdesign Shpk	614,456	
	<u>1,818,812</u>	<u>697,304</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

24. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2015, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.